

# RRUGËT E SHTIMIT TË EKSPORTIT SHQIPTAR

## Hyrje

Shqipëria ka përjetuar një periudhë të vështirë dymbëdhjetëvjeçare tranzicioni, të karakterizuar nga përpjekjet për vendosjen e një sistemi ekonomik të orientuar nga tregu i lirë. Ajo ka bërë progres në stabilitetin makroekonomik dhe në reformat strukturore, pavarësisht vështirësive të procesit të tranzicionit, krizës ekonomike dhe sociale të vitit 1997 dhe asaj të Kosovës të vitit 1999.

Edhe pse këto vitet e fundit vihet re rritje ekonomike (për vitin 2002, ekonomia e vendit pati një rritje prej 4,7 për qind në krahasim me vitin 2001<sup>1</sup>), Shqipëria mbetet vendi më i varfër në Evropë me vetëm PBB për frymë prej 1521 usd në vit, me një bilanc tregtar mjaft negativ, me gjendje të dobët të infrastrukturës bazë, me një sistem financiar që ende nuk u përgjigjet si duhet nevojave të biznesit si dhe me institucione private dhe publike të papërgatitura si duhet për të marrë mbi vete përgjegjësi në një sistem të ri ekonomik, të cilin kemi pranuar ta ndërtojmë.

Shqipëria tani përballet me sfidën e re të rritjes së aftësive konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe me synimin për hyrjen në Bashkimin Evropian. Siç dihet, një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen ekonomike të një vendi dhe që pasqyron rritjen e aftësisë konkurruese është tregtia e jashtme. Në vitin 2002, Shqipëria ka regjistruar nivelin më të lartë të tregtisë së mallrave, i cili kundrejt vitit 2001 vlerësohej 12 për qind më shumë. Kështu, importi i mallrave kapi 1,5 miliardë dollarë ose 12 për qind më shumë kundrejt vitit 2001, ndërsa eksporti i mallrave 330 milionë dollarë ose 8 për qind më shumë se viti 2001<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Raport Vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2002, faqe 58.

<sup>2</sup> Raport Vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2002, faqe 59.

Nga këto të dhëna vihet re se ekonomia e vendit tonë ka një orientim të theksuar drejt importit, i cili kontribuon në masën 82 për qind në vëllimin e tregtisë së jashtme. Rritja më e lartë e importeve krahasuar me eksportet ka çuar në thellimin e mëtejshëm të deficitit tregtar, i cili është i lidhur me shkallën e ulët të aftësisë konkurruese të prodhimit të brendshëm.

### **1. Ku jemi me import-eksportet?**


Me hyrjen në ekonominë e tregut dhe me hapjen ndaj tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, fluksi i importeve në Shqipëri u rrit ndjeshëm, si rezultat i boshllëkut (mungesës të mallrave në treg), i rritjes të kërkesës së brendshme dhe i pamundësisë së prodhimit të brendshëm për t'iu përgjigjur këtyre nevojave shpërthyesë. Megjithë rritjet që kanë shënuar eksportet gjatë kësaj periudhe, deficitin tregtar vazhdon të thellohet vit pas viti, siç shihet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 1: Bilanci tregtar në vite (në milionë usd).

VITI	1993	2000	2002
Importi në mln usd	360	1156	1485
Eksporti në mln usd	105	283	330
Bilanci tregtar në mln usd	-255	-873	-1155


Raporti import-eksport tregon një përkeqësim të lehtë të këtij treguesi, i cili nga 23,8 për qind që ishte në vitin 2000, ka shkuar 22,8 dhe 22,2 për qind përkatësisht për vitet 2001 dhe 2002.

Grafik 1: Paraqitja grafike e bilancit tregtar në vite (në milionë usd).



Krahasuar me prodhimin e brendshëm bruto vëllimi i eksportit është në shifra shumë të vogla dhe varion në këtë dymbëdhjetëvjeçar të fundit nga 6-7,5 për qind, gjë që do të thotë se ekonomia shqiptare aktualisht nuk ka as superprodhim në përgjithësi, as nuk shfrytëzon epërsitë në segmente të veçanta të ekonomisë që mund të destinohen vetëm për eksport.

Grafik 2: Ecuria e rritjes së eksporteve dhe importeve tregtare në vite (në përqindje).



Parë në strukturën e tyre, eksportet nga prodhimi i vendit dhe ato nga përpunimi aktiv, me rrjedhën e viteve kemi një situatë të tillë: në vitet 1993-1996, eksportet

janë dominuar nga prodhimi i brendshëm dhe pas këtyre viteve kemi një rritje të eksportit nga përpunimi aktiv.

Rritja në eksporte gjatë vitit 2002 erdhi në një masë të konsiderueshme si rezultat i rritjes së vëllimit të rieksperteve (eksporte me material porositësi), me 9,2 për qind në krahasim me vitin 2001. Ecuria e eksporteve shqiptare duke parë realizimin e tij nga prodhimi i brendshëm dhe nga përpunimi aktiv, për periudhën 1999 – 2002 paraqitet si më poshtë:

Tabelë 2 Ecuria e eksporteve në Shqipëri.

VITI	Ekporti nga prodhimi i brendshëm (1)	Eksporti nga përpunimi aktiv (2)	Eksporti gjithsej (3) = (1)+ (2)
1999	10704	20698	31402
	<b>34 për qind</b>	<b>66 për qind</b>	<b>100 për qind</b>
2000	9312	21697	30991
	<b>30 për qind</b>	<b>70 për qind</b>	<b>100 për qind</b>
2001	9392	21599	36209
	<b>27 për qind</b>	<b>73 për qind</b>	<b>100 për qind</b>
2002	9556	27614	37170
	<b>26 për qind</b>	<b>74 për qind</b>	<b>100 për qind</b>

Siç shihet, riekspertet vazhdojnë të mbajnë pjesën kryesore të eksporteve tona, me rreth 74 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Kjo rritje është shoqëruar dhe me rritjen e importeve të lëndëve të para për industrinë tekstile dhe të përpunimit të lëkurëve, të cilat zënë respektivisht 11 për qind dhe 3,6 për qind të vëllimit të importeve. Sigurisht që këta tregues, së bashku me importet e makinerive e pajisjeve si dhe të mjeteve të transportit, të cilat vazhdojnë të ruajnë një peshë specifike afërsisht 20 për qind në totalin e importeve, reflektojnë zhvillimet e sektorit prodhues të ekonomisë.

Gjithashtu në rritje, edhe pse jo i dukshëm në vëllim, shfaqet eksporti nga prodhimi i brendshëm (me 4 për qind). Eksporti i brendshëm përfaqësohet nga produkte bujqësore (bimë mjekësore, duhan), nga metale (ferrokrom dhe alumin), nga lëkura, nga lëndë drusore dhe nga produkte minerale (karburante). Eksportet industriale kanë humbur rëndësinë e tyre me falimentimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Një vend të rëndësishëm zë edhe turizmi. Statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2002, theksuan edhe më shumë prirjen pozitive të veprimtarisë së turizmit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, kjo veprimtari ka gjeneruar të ardhura rreth 486 milionë dollarë, shifër kjo rreth 47 për qind më e lartë se eksporti i mallrave. Ndërkohë që shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 366 milionë dollarë amerikanë ose rreth 60 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët<sup>3</sup>. Mund të thuhet se gjatë vitit 2002 ka pasur një rritje të madhe në numrin e udhëtarëve që kanë vizituar Shqipërinë, me rreth 20 për qind kundrejt vitit të kaluar dhe ky mund të konsiderohet si një tregues i mjaftueshëm, që dëshmon për rritjen e veprimtarisë në këto shërbime. Gjithashtu, vihet re një rritje e madhe edhe në shpenzimet ditore të shqiptarëve që udhëtojnë jashtë shtetit me 39 për qind, faktor ky që ka ndikuar në rritjen prej 42 për qind të shpenzimeve të turizmit kundrejt vitit 2001. Për rrjedhojë, në fund të vitit 2002, bilanci pozitiv i shërbimeve të kësaj kategorie vlerësohej në 121 milionë dollarë amerikanë. Me një veprimtari të tillë, turizmi ka dominuar të gjitha zhvillimet në tregtinë e shërbimeve duke zënë rreth 83 për qind në eksportet dhe 62 për qind në importet e shërbimeve.

---

<sup>3</sup> Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2002, faqe 60.

Siç u përmend, struktura e eksporteve paraqitet e dominuar nga produktet e përpunimit aktiv në tekstile dhe këpucë, të orientuar drejt tregjeve të Bashkimit Evropian.

Tabelë 3: Struktura e import-eksporteve<sup>4</sup>.

Nr.	STRUKTURA E IMPORTEVE	1996	2002
1	Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë shtazore	5,0	3,0
2	Produkte vegjetale	17,5	6,8
3	Vajra dhe yndyrna shtazore apo vegjetale	2,9	1,4
4	Ushqime të përgatitura, pije, duhan	9,5	8,8
5	Produkte minerale	5,2	12,9
6	Produkte të industrisë kimike apo të industrisë së lidhjeve	4,8	5,8
7	Plastika; goma dhe artikuj të tyre	2,3	3,0
8	Lëkura, artikuj të tyre	2,1	2,5
9	Druri, tapa artikuj të tyre; prodhime kashte, kallama	0,8	1,1
10	Brumi i drurit, letra kartoni, artikuj të tyre	1,4	2,0
11	Tekstile dhe artikuj tekstilë	9,0	10,9
12	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat	6,3	3,7
13	Artikuj prej guri, allçie, çimentoje, qeramike, qelq	2,4	3,9
14	Perla; bizhuteri; monedha	0,1	0,0
15	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	4,8	9,0
16	Makineri e pajisje mekanike, elektrike	16,2	16,2
17	Mjete transporti	6,1	5,4
18	Instrumente e aparate optike, orë, instrumente muzikore	1,3	1,0
19	Armë e municione, pjesë plotësuese të tyre	0,1	0,0
20	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	2,1	2,5
21	Vepra arti, copa të mbledhura nga antikat	0,0	0,0
	TOTALI	100,0	100,0



Nr.	STRUKTURA E EKSPORTEVE	1996	2002
-----	------------------------	------	------

<sup>4</sup> Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2002, faqe 59.

1	Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë shtazore	3,1	0,6
2	Produkte vegjetale	7,1	4,0
3	Vajra dhe yndyrna shtazore apo vegjetale	2,2	0,0
4	Ushqime të përgatitura, pije, duhan	4,1	2,2
5	Produkte minerale	10,3	2,8
6	Produkte të industrisë kimike apo të industrisë së lidhjeve	1,2	0,5
7	Plastika; goma dhe artikuj të tyre	0,5	0,2
8	Lëkura, artikuj të tyre	4,5	4,5
9	Druri, tapa artikujt e tyre; prodhime kashte, kallama	2,8	2,6
10	Brumi i drurit, letra kartoni, artikujt e tyre	1,4	0,9
11	Tekstile dhe artikuj tekstilë	24,4	37,7
12	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat	23,4	28,9
13	Artikuj prej guri, allçie, çimentoje, qeramike, qelq	0,2	0,6
14	Perla, bizhuteri, monedha	0,0	0,1
15	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	11,3	9,3
16	Makineri e pajisje mekanike, elektrike	1,7	2,5
17	Mjete transporti	0,1	0,3
18	Instrumente e aparate optike, orë, instrumente muzikore	0,1	0,1
19	Armë e municione, pjesë plotësuese të tyre	0,3	0,2
20	Artikuj të ndryshëm të prodhuar	1,4	2,1
21	Vepra arti, copa të mbledhura nga antikat	0,0	0,0
	TOTALI	100,0	100,0

Pra, siç shihet kemi një përmirësim të strukturës së eksportit për tekstilet, për artikujt e tekstileve, për veshjet e këmbës, kokës e çadrat dhe një rritje gjithashtu të importeve të prodhimeve minerale, dhe të produkteve të industrisë kimike.

Grafik 3: Gjeografia e eksporteve dhe importeve shqiptare.



Nga kjo paraqitje vihet re se eksportet janë orientuar kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian, më shumë drejt Italisë dhe Greqisë.

Regjimi tregtar asimetrik i Shqipërisë dhe i disa vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian akorduar nga Bashkimi Evropian për vitin 2002, është shfrytëzuar në përgjithësi në një nivel të ulët dhe kryesisht në artikuj të tillë si: *acuge* (me fason), domate në masën 33 për qind të kuotës, piper i ëmbël 9 për qind, shalqin 43 për qind etj..

E njëjta situatë paraqitet edhe për origjinën e importeve, ku vendin e parë dhe të dytë e zënë përkatësisht Italia dhe Greqia.

Eksportet shqiptare drejt vendeve që kanë nënshkruar memorandumin<sup>5</sup> për liberalizmin e tregtisë janë në shifra mjaft të vogla, megjithëse prirja në këto tre vitet e fundit është në rritje. Nga këto vende, peshën më të madhe e zënë eksportet drejt vendeve kufitare dhe janë kryesisht artikuj konsumi, lëndë ndërtimi, bitum naftë etj.. Kosova ka zënë peshën më të madhe në eksportet dhe përbën rreth 90 për qind të totalit të eksportit (por, paraqitet me Jugosllavinë për arsye statistikore). Në tremujorin e parë të vitit 2003 me Kosovën janë realizuar 871178 dollarë dhe kryesisht artikuj konsumi ushqimorë dhe lëndë ndërtimi.

Tabelë 4: Eksportet me vendet e memorandumit.

N R	SHTETET	2000		2001		2002	
		000 /USD	%	000 /USD	%	000 /USD	%
1	Bosnje - Hercegovinë	0	0	7,7	0,05	74,2	0,6
2	Bullgari	78	0,7	94,7	0,66	97,8	0,8
3	Serbi, Mali i Zi dhe Kosovë	7088,4	64,2	9503,3	66,1	7457	58,3
4	Kroaci	1385,3	12,6	49,7	0,35	158,4	1,2
5	Maqedoni	2479,6	22,5	4719	32,83	4867,7	38,7
6	Rumani	4,03	0,04	0	0	57,9	0,5
<b>A</b>	<b>Vendet e memorandumit</b>	<b>11035,3</b>	<b>4,25</b>	<b>14374,6</b>	<b>4,7</b>	<b>12713,6</b>	<b>3,76</b>
<b>B</b>	<b>Vendet e tjera</b>	<b>249543</b>	<b>95,75</b>	<b>289502,7</b>	<b>95,3</b>	<b>325411</b>	<b>96,2</b>
	<b>Shuma eksportit</b>	<b>260578</b>	<b>100</b>	<b>303877</b>	<b>100</b>	<b>338124,8</b>	<b>100</b>

<sup>5</sup> Të dhënat janë marrë në Ministrinë e Ekonomisë.

## **2. Cilat janë arsyet për këtë raport të zhdrejtë?**

Bilanci tregtar i Shqipërisë vazhdon të jetë negativ, si pasojë e nivelit të ulët të eksporteve. Siç e përmendëm, eksporti i brendshëm ze një peshë shumë të vogël dhe përfaqësohet kryesisht nga produkte bujqësore. Eksportet industriale kanë humbur rëndësinë e tyre që me falimentimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Kjo pasqyrohet qartë në industrinë minerale. Mineralet kryesore që tradicionalisht janë nxjerrë në Shqipëri kanë qenë kromi, bakri, ferrokromi, hekur-nikeli si dhe produkte nga rafineria e naftës, të cilat deri në mesin e viteve '90 kanë përbërë një komponent dominues në të ardhurat nga shkëmbimet e huaja.

Kështu, në ekonominë e centralizuar, kryesisht nga fundi i viteve '70 deri në vitin 1990, Shqipëria renditej e dyta në botë, përta i përket eksportit të kromit (pas Afrikës së Jugut) dhe e treta për prodhimin e tij (pas Afrikës së Jugut dhe Bashkimit Sovjetik). Në vitin 1999 prodhimi i kromit ra ndjeshëm, me 47 për qind krahasuar me atë të vitit 1998. Kriza që kaloi industria nxjerrëse e kromit si pasojë e grevave të vazhdueshme që goditën këtë industri, ndikoi negativisht në realizimin e eksportit të këtij minerali edhe gjatë viteve në vazhdim.

Ndërsa, po të analizojmë industrinë e bakrit do të shohim se prodhimi i bakrit në vend arriti nivelin e tij më të lartë rreth fundit të viteve '80. Në vitin 1999 prodhimi i mineralit të bakrit ra me rreth 37 për qind kundrejt vitit paraardhës. Prodhimi i bakrit të rafinuar ra ndjeshëm me 70 për qind dhe ai i bakrit kabëll dhe tel ndoqi rënien, e cila kishte filluar që në vitin 1993.

Ndërkaq, në të kaluarën prodhimi i energjisë elektrike, i gazit natyror dhe naftës, si dhe konsumi i ulët i karburanteve në vend, e bënë Shqipërinë eksportuese të energjisë.

Reduktimi i prodhimit të energjisë elektrike, si rezultat i disa viteve thatësire, rënia në prodhimin e naftës, si dhe rritja e nevojave të brendshme për energji elektrike bënë që Shqipëria të humbasë statusin e saj si eksportuese në këtë sektor. Rënia drastike e eksporteve në minerale vlerësohet si faktori i rëndësishëm që ndikoi në uljen e vëllimit të eksportit të brendshëm, duke sjellë njëkohësisht edhe ndryshim në strukturën e tij. Ka humbur ndjeshëm në peshë kategoria "materiale të papërpunuara", e përfaqësuar kryesisht nga eksportet në minerale dhe kategoria "lëndë djegëse" në të cilën përfshihet edhe eksporti i energjisë elektrike.

Nivelet e ulëta, që karakterizojnë eksportin e brendshëm tregojnë se potencialet e ekonomisë për eksport nuk po arrihet të shfrytëzohen. Një nga shumë arsyet është edhe gjendja në pritje për privatizimin e industrisë minerale, e cila tradicionalisht ka patur një peshë shumë të rëndësishme në eksportin shqiptar. Kjo vonesë ka ulur më shumë nxjerrjen e mineraleve.

Aktualisht, në nivelin e ulët të eksporteve ndikojnë edhe shumë faktorë, disa prej të cilëve mund t'i përmendim:

- Mbizotërimi i njësisive prodhuese shumë të vogla bujqësore dhe të pashfrytëzuara, shumica e të cilave momentalisht ka një potencial të vogël prodhues për treg. Këto njësi kanë vështirësi për marrje kredie, që mund ta përdorin për zgjerim dhe për blerjen e mjeteve të tjera për intensifikimin e përdorimit të tokës ose për modernizimin e saj.
- Mbizotërimi i punishteve të vogla, kryesisht me pajisje të vjetra, të cilat kanë vetëm rëndësi lokale apo rajonale dhe që nuk mund të përmbushin lehtësisht kërkesat e tregjeve të Bashkimit Evropian nga pikëpamja e cilësisë dhe e higjienës.
- Mungesa e standardizimit të produkteve dhe mungesa e markave të prodhimit.

- Pamjaftueshmëria e infrastrukturës për furnizimin me lëndë të para, për tregtimin e produkteve dhe për parapërpunimin eventual të tyre.
- Vështirësia e organizimit të prodhuesve të vegjël, me qëllim grumbullimin e sasive të mjaftueshme për t'i përpunuar për treg dhe për t'i eksportuar me leverdi ekonomike.
- Shkatërrimi i pjesës më të madhe të strukturave të mëparshme ekzistuese dhe kapaciteteve prodhuese, me përjashtim vetëm të industrisë tekstile, të veshjeve dhe këpucëve.
- Mungesa e infrastrukturës dhe marketingu i dobët për përmirësimin e imazhit për zhvillimin turistik të vendit.
- Mungesa e kapitalit për të investuar për pajisje moderne prodhimi si dhe mungesa e informacionit mbi burimet e furnizimit të teknologjive të përshtatshme.
- Shumë drejtues nuk kanë njohuri të mjaftueshme për metodat moderne të drejtimit. Ata janë thjesht të orientuar nga prodhimi dhe u mungojnë njohuritë veçanërisht në fushën e marketingut.
- Nivelet e prodhimtarisë janë të ulëta në krahasim me vendet e synuara, kështu që kompetitiviteti ndërkombëtar është i ulët për këto faza prodhimi, të cilat mund të automatizohen lehtë.
- Mungesa e kontakteve të komunitetit të biznesit me partnerë potencialë në tregjet e huaja dhe vështirësitë që kanë drejtuesit ose pronarët për të udhëtuar drejt vendeve me të cilat synojmë të bëjmë tregti.

Si rrjedhojë e faktorëve të mësipërm, prirjet e konsumit dhe zhvillimet në tregjet e vendeve potenciale të synuara janë të panjohura (të tilla si lëvizja drejt produkteve konforte) ndërsa ka kërkesa (për shembull, në lidhje me standardet e higjienës, të paraqitjes së produktit, të vazhdueshmërisë së furnizimit etj.) të cilat duhen

plotësuar nga çdo furnizues, që synon të sigurojë për vete një pjesë të këtyre tregjeve.

Gjithashtu, ka njohuri të pakta për kërkesat e shërbimeve ndaj klientelës së përgjithshme turistike dhe të atyre, të cilët mund të ndihmojnë në tërheqjen e grupeve të veçanta të turistëve.

### **3. Ç'duhet bërë për të shtuar eksportet?**

Pavarësisht nga sa më sipër, fakti që vendi ka mundur të eksportoje me sukses disa produkte, është një provë që tregon se ekziston një potencial i përgjithshëm për eksport dhe mund të ngrihet një bazë, mbi të cilën mund të bëhen përpjekje për të përmirësuar dhe për të zgjeruar bazën e eksportit.

Ekonomia shqiptare nuk ka shfrytëzuar si duhet kapacitetet e brendshme, kjo edhe për shkak të krizës energjitike e cila ka ndikim të rëndësishëm në rentabilitetin e të gjithë sektorëve të ekonomisë.

Duke u nisur nga situata e viteve të fundit të eksporteve, e ritmeve të rritjes, nga arritjet në disa segmente të ekonomisë, në importet e makineri e pajisje për bujqësinë dhe për sektorë të tjerë të ekonomisë, nga investimet publike që janë realizuar dhe nga shumë reforma në proces, nga hapja dhe zgjerimi i tregut të rajonit, sidomos me Maqedoninë dhe nga intensifikimi i marrëdhënieve tregtare me Kosovën, shpresohet një zhvillim dhe përmirësim i aftësisë konkurruese në perspektivën rajonale.

Më poshtë paraqesim një perspektivë të eksporteve sipas strukturës së tyre nga prodhimi i brendshëm dhe përpunimi aktiv, të vlerësuara në milionë usd<sup>6</sup>.

Tabelë 5: Parashikimi i eksporteve deri në vitin 2005, në milionë dollarë usd.

VITI	Ekporti nga prodhimi i brendshëm (1)	Ekporti nga përpunimi aktiv (2)	Ekporti gjithsej (3) = (1)+ (2)
2003	112,3	286,1	398,4
	<b>28,2 për qind</b>	<b>72,8 për qind</b>	<b>100 për qind</b>
2004	151,6	306,6	458,2
	<b>33,1 për qind</b>	<b>66,9 për qind</b>	<b>100 për qind</b>
2005	212,2	314,7	526,9
	<b>40,3 për qind</b>	<b>59,7 për qind</b>	<b>100 për qind</b>

Pra, për vitet e ardhshme janë mbajtur parasysh, ritmi mesatar vjetor i rritjes për eksportet në përgjithësi me 18,3 për qind, për prodhimin e brendshëm me 30 për qind dhe 10,4 për qind për përpunim aktiv.

Rritje më e madhe në prodhimin e brendshëm mendohet të jetë:

- në produktet vegjetale si ato medicinale, erëza e perime të freskëta të ndryshme;
- në prodhimet shtazore si mish, bulmet, peshk etj.,
- në ushqime, pije, duhan (lëngje frutash, ujra ),
- në lëndët e ndërtimit (çimento, gëlqere),
- në minerale e metale të ndryshme (krom, bakër etj.),
- në lëkurët e ndryshme,
- në drurin e prodhimet e tij,
- ndërsa në seksionet e tekstileve dhe të veshjeve të këmbës, rritja i përket përpunimit aktiv.

<sup>6</sup> Të dhënat janë marrë në Ministrinë e Ekonomisë.

Parë në aspektin e peshës specifike, mendohet se do të rritet pesha e prodhimit të brendshëm pasi të ardhurat e punonjësve do të jenë në rritje, kështu që interesi me fason do të fillojë të bjerë me rrjedhën e viteve.

Këto vlerësime janë relativisht të argumentuara, mbasi në këtë parashikim do të ndikonin edhe shumë faktorë të tjerë, si një njohje më e hollësishme e eksporteve dhe e faktorëve përkatës nga institucione të specializuara.

Sigurisht që impulset kryesore për rritjen ekonomike do të vijnë nga sektori privat, ashtu siç ndodhi gjatë viteve të para të tranzicionit dhe gjatë rimëkëmbjes ekonomike pas krizës së vitit 1997. Por, për shkak të problemeve të përmendura me sipër, sektori privat ende nuk është i aftë për shfrytëzimin e avantazheve konkurruese të Shqipërisë, pavarësisht nga mundësia që ofron liberalizimi në praktikë i sistemit të kontrollit shtetëror.

Në sektorin e bujqësisë është i domosdoshëm përmirësimi i prodhimit bujqësor në sasi dhe në thellësi. Për këtë, duhet të modernizohen metodat në bujqësi dhe të paraqiten metoda të reja si bujqësia organike. Kjo kërkon ndërmarrjen e veprimtarive të tilla, të cilat do të rritnin mundësinë e veprimeve me tokën. Gjithashtu, do të lehtësonin investimet në nivel ekonomie bujqësore, të cilat synojnë përmirësimin e intensifikimit të përdorimit të tokës dhe të produktivitetit të saj, do të përmirësonin njohuritë dhe aftësitë e fermerëve si dhe dëshirën e tyre për të hyrë në marrëdhënie kontraktore ose për të formuar grupe për tregtimin dhe për furnizimin me lëndë të para. Përveç kësaj, nevojiten të bëhen përmirësime në komunikim dhe në infrastrukturën e qarkullimit rrugor.

Në sektorët jobujqësorë, mund të nevojitet nxitja e investimeve, duke patur si qëllim modernizimin e njësive prodhuese. Duhet të freskohen njohuritë teknike

dhe ato të marketingut, të formulohet një strategji e veçantë si dhe të krijohet një infrastrukturë e tillë, që të krijojë mundësinë për përmirësimin e shërbimeve.

Një faktor që pengon zhvillimin në të gjithë sektorët është izolimi relativ i prodhuesve dhe i drejtuesve të kompanive shqiptare nga tregjet e synuara. Prandaj, kërkohen të mbështeten më shumë ato veprimtari që lehtësojnë udhëtimet e pronarëve ose të drejtuesve të kompanive shqiptare në vendet e synuara, në mënyrë që ato të mund të informohen për kushtet e këtyre tregjeve, të krijojnë ide mbi kërkesat e tyre dhe të paraqesin imazhin e Shqipërisë si furnizuese ose eksportuese në sektorët specifikë.

Fakti që për vitin 2002, të ardhurat nga turizmi ishin 47 për qind më të larta se vlefata e përgjithshme e eksporteve shqiptare kërkon që zhvillimi i turizmit të jetë një ndër pikat më prioritare të strategjisë kombëtare të zhvillimit. Megjithë konkurrencën e fortë nga vendet e rajonit (Greqia, Mali i zi, Kroacia), sektori i turizmit tregon se ka potencialin të bëhet një motor i fuqishëm i rritjes ekonomike.

Parë në këndvështrimin e përgjithshëm, perspektiva e eksportit të mallrave paraqitet optimiste nisur nga shumë faktorë të ndryshëm, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në rritjen e nivelit të eksportit të mallrave si :

1. Politikat e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit dhe angazhimet për një politikë tregtare në rajon e më gjerë gjithnjë e më liberale.
2. Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit të eksporteve dhe të strukturës përkatëse për implementimin e saj.
3. Përmirësimi i sistemit financiar dhe bankar si dhe rritja e aftësisë kredituese në ekonomi.
4. Rritja e investimeve publike në infrastrukturën e rrugëve, të hekurudhës, të ujit si dhe të shërbimeve telefonike etj..

5. Rritja në mënyrë të vazhdueshme e investimeve vendase dhe të huaja në ekonomi, sidomos në industrinë e lehtë ushqimore dhe në atë të mineraleve e metaleve.
6. Angazhimet e qeverisë për lehtësimin dhe për heqjen e barrierave administrative në dobi të zhvillimit të biznesit në përgjithësi.
7. Angazhimet e qeverisë për zgjidhjen e problemit të pronësisë, i cili i hap perspektivë të madhe investimeve në ekonomi.

Gjithashtu, një faktor shumë i rëndësishëm që do të ndikonte në rritjen e eksporteve është standardizimi i prodhimit sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare. Kjo do të përmirësonte dhe imazhin e Shqipërisë si eksportuese potenciale.

### **Përfundime**

- ✓ Eksportet nga prodhimi i brendshëm në vitet e para të dymbëdhjetëvjeçarit të fundit kanë qenë të dominuara nga disa produkte stoqe dhe njësi prodhuese të trashëguara nga ekonomia e sistemit të mëparshëm. Në këto vitet e fundit, si rezultat i reformave, i privatizimit dhe i nevojës për ristrukturim të ekonomisë, prodhimi i ekonomisë sonë ka pësuar një rënie të madhe sidomos në artikuj për eksport.
- ✓ Prirja e këtyre viteve ka qenë shtimi i deficitit tregtar. Raporti i eksportit ndaj PBB-së (GDP) ose quajtur ndryshe përqindja e eksportimit, krahasimisht me vitet e mëparshme ka patur rënie. Ky deficit tregtar dëshmon vështirësitë financiare në bilancin e pagesave me jashtë, çka do të thotë se ekonomia jonë duhet të shesë disa nga aktivet (asetet) e saj ose të presë ndihma (grante) financiare nga vende të tjera. Për të zbutur këtë shpërpjesëtim midis eksport-importit janë dy rrugë të mundshme: *rritja e promovimi i eksporteve si dhe prodhimi në vend*

*i disa produkteve, që importohen dhe që ekonomia shqiptare i ka mundësitë reale për t'i hequr nga lista e importit.*

- ✓ Prirjet e eksportit janë në rritje me disa vende si: Jugosllavi (+Kosovë), Turqi, SHBA, Zvicër etj. dhe kryesisht në artikuj të ekonomisë së brendshme, materiale ndërtimi, lëkurë, bimë medicinale, minerale etj..
- ✓ Raportet jo të mira midis eksportit dhe importit janë me pasoja të rënda në zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi, kur dihet se aktualisht kompensimi nga sektori i shërbimeve (turizëm, transport, financë etj.) është i pamundur, mbasi edhe ky sektor është në nivele të ulëta zhvillimi. Gjithashtu, edhe shitja e aktiveve të ekonomisë ka kufijtë e saj, donacionet janë të përkohshme dhe të ardhurat nga emigrantët po vijnë në rënie. Pra, parë në këtë këndvështrim, mund të themi se deficitit tregtar po të vazhdojë të thellohet, do të bëhet pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë në tërësi. Mbas vitit 2005 mendohet të fillojë zbutja e deficitit tregtar.
- ✓ Nxitja e eksporteve, pa dyshim është një mekanizëm shumë i fuqishëm i rregullimeve strukturore, që ka efektin e tij në bilancin e pagesave. Në kuadrin e politikës ekonomike të Shqipërisë, zhvillimi i eksporteve konsiderohet si një faktor kyç për përmirësimin e treguesve makroekonomikë, veçanërisht nga pikëpamja e përmirësimit të bilancit tregtar (aktualisht mjaft negativ) dhe e krijimit të vendeve të punës.
- ✓ Për Shqipërinë, tërheqja e IHD (investimet të huaja direkte) mund të jetë një mënyrë racionale për zhvillimin e potencialeve ekzistuese të eksportit, për sigurimin e kapaciteteve të reja të eksportit, për sigurimin e hyrjes së menjëhershme në treg dhe për krijimin e avantazheve konkurruese dinamike. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e prodhimit të orientuar për eksport. Gjithashtu, miratimi i Strategjisë Afatmesme për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme është vendimtar për përmirësimin e aftësisë konkurruese të industrisë shqiptare, e

cila përbëhet në 95 për qind nga ndërmarrje tepër të vogla, të vogla dhe të mesme.

- ✓ Për të tërhequr më shumë investime të huaja, për të modernizuar njësitë e prodhimit të këtij sektori duhen zbatuar disa incentiva, si dhe mund të përmirësohet politika e taksave për investimet në makineri në sektorin e prodhimit, të hiqet apo të reduktohet TVSH për makineritë, për veprimtarinë e kompanive që operojnë në fushën e prodhimit etj..
- ✓ Në sektorin bujqësor, qëllimi imediat është përmirësimi i prodhimit bujqësor në sasi dhe në cilësi. Për këtë, metodat e fermave duhet të modernizohen dhe të shtohen prodhimet organike. Në prirjen e sotme të tregjeve evropiane produktet "bio" po konkurrojnë me lehtësi. Kjo kërkon veprime konkrete si: lehtësimi i investimeve me qëllim përmirësimin e produktivitetit të tokës në përdorim, përmirësime të njohurive dhe të aftësive të fermerëve si dhe nxitja e dëshirës për të formuar grupe për marketingun dhe për furnizimin me inpute.

Në mënyrë të përmbledhur problemet kryesore për zhvillimin e eksporteve janë:

- Identifikimi i avantazheve konkurruese dhe zhvillimi i tyre.
- Nxitja e investimeve të huaja të direkte.
- Zhvillimi i bazës prodhuese në vend.

Shqipëria me pozitën e saj gjeografike, me burimet natyrore, me relievin, me klimën dhe me një treg të brendshëm relativisht të vogël, i ka të gjitha mundësitë për t'u bërë një eksportuese potenciale për tregjet e Evropës.

Zbutja e krizës energjetike nëpërmjet politikave sektoriale do të ndikojë me një kah shumë pozitiv në zhvillimin e ekonomisë në vend si dhe në eliminimin e atyre aspekteve përkeqësuese si në rastin e importimit me shumicë të mjeteve elektromekanike si gjeneratorë, elektromotorë etj..

Gjithashtu, zëvendësimi i karburanteve të përpunuara me naftë bruto që mund të përpunohet nga industria përpunuese vendase, mund të japë efekt mjaft pozitiv në zbutjen e këtij deficiti. Njëkohësisht, politikat mbështetëse për këta sektorë, janë të domosdoshme.

Një bashkërendim i punës së institucioneve shtetërore që kanë të bëjnë me politikat sektoriale, me bashkërendimin e tyre, me vendimmarrjen për kursin e këmbimit, që në fakt përbëjnë thelbin e një strategjie eksportesh, do të krijojë terren të favorshëm për zhvillime pozitive lidhur me bilancin tregtar.

Bujqësia dhe agroindustria janë degët potenciale të ekonomisë, që kanë shumë premisa për të zbutur deficitin tregtar në kuptimin e zëvendësimit të produkteve të importit me produkte të vendit. Në këtë kontekst, kreditimi i bujqësisë dhe i agroindustrialisë përbën një aspekt shumë eficient të përmirësimit të situatës së deficitit tregtar.

*Me qëllim që të minimizohet sa më shumë që përmirësohet raporti i eksport-importit, krahas masave afatgjata e të qëndrueshme, kërkohen edhe zgjidhje të menjëhershme:*

- ▶ Të bëhen studime për ngritjen e qendrave të grumbullimit në bazë zonash të ndryshme, ku mallrave t'u bëhet edhe marketingu në këto qendra grumbullimi, manipulimi, standardizimi e paketimi.
- ▶ Të nxiten dhe të mbështeten iniciativat, që do të mundësonin shfrytëzimin e alternativave të tjera të energjisë sidomos të asaj diellore, bazuar edhe në rezultatet e disa vendeve të tjera si Greqi, Francë, Spanjë etj..
- ▶ Të promovohet importimi i naftës bruto, ku kapacitetet përpunuese janë të konsiderueshme, gjë që veç të tjerave, do të minimizonte deficitin tregtar dhe do të ulte koston e prodhimit të produktit për njësi.

► Të përkrahet sektori i prodhimit të lëndëve e materialeve të ndërtimit, kur dihet që artikuj të tillë janë shumë të kërkuar në tregun e brendshëm, por edhe potenciale për eksport sidomos në rajon.

► Të vendosen kritere dhe norma në ndërtimin e banesave, përse i përket ngrohjes qendrore të cilat do të eleminonin nga importi artikuj të tillë si rezistenca të ndryshme për ngrohje, kondicionerë, bolierë etj..

► Të administrohet më mirë problemi i ujit të pijshëm, zgjidhja e të cilit do të kishte efektet e veta në eliminimin nga importi të një kategorie mallrash si: rezervuarët, depozitat, pompat e ngritjes së ujit në kate të larta.

Për t'i shërbyer punës së mëtejshme në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar, shumë struktura të qeverisë dhe të biznesit duhet të arrijnë që:

- Të sigurojnë të dhëna analitike dhe në vijueshmëri për çdo produkt që destinohet për eksport.
- Të evidentojnë prodhuesit dhe grosistët, që merren me eksportimin e prodhimeve të ndryshme të vendit.
- Të evidentojnë produktet që janë potencialisht të eksportueshme, por që ende nuk kanë arritur të gjejnë tregje.
- Të evidentojnë produktet dhe prodhuesit vendas që kanë nevojë për mbrojtje të përkohshme ndaj importimit të këtyre produkteve.
- Të evidentojnë produktet, që mund të hiqen nga importi, të cilat ekonomia jonë mund t'i prodhojë në vend.
- Të realizojnë informimin dhe propagandën për prodhimet bujqësore-blegtorale si dhe ato të industrisë së lehtë dhe ushqimore, që janë produkte me shije dhe biologjikisht të pastra, për të cilat ka kërkesa të larta tregu i jashtëm.
- Të sigurojnë informacion dhe të dhëna mbi çmimet, mbi kërkesat, mbi kompanitë dhe mbi rregullat e tregjeve e jashtme.

Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë shqiptare të orientuar për eksport, do të varet nga ngritja e suksesshme e kapaciteteve respektive politike, institucionale, teknike dhe administruese.

Koncepti i aftësisë konkurruese si sistem është zgjedhur dhe është theksuar si mbështetës racional i nxitjes së eksporteve shqiptare, bazuar në parimet e partneritetit të qëndrueshëm privat-publik, në një qëndrimin të integruar ku përfshihen:

- prodhimi dhe logjistikat e orientuara nga tregu (roli i komunitetit të biznesit);
- shërbimet e orientuara nga biznesi (roli i organizatave publike dhe private);
- kushtet bazë legislative dhe administrative të orientuara nga biznesi (roli i qeverisë).

Qëndrimi strategjik ndaj nxitjes së eksporteve ka për qëllim përfshirjen dhe bashkëpunimin e ngushtë midis të gjithë aktorëve, me qëllim përfitimin nga qëndrimet plotësuese dhe nga efektet e sinergjisë. Kështu, lidhjet funksionale midis organizatave publike dhe private, komunitetit të biznesit dhe organizatave donatore si dhe kontributi i qeverisë do të jenë vendimtare për suksesin e nxitjes së eksporteve shqiptare.

Problemet kryesore që kanë të bëjnë me qëndrimin nxitës ndaj eksporteve janë:

- Integrimi zyrtar i nxitjes së eksporteve në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit ekonomik.
- Institucionalizimi i partneritetit publik-privat në planifikimin, në zbatimin në monitorimin dhe në përmirësimin e strategjisë.
- Ngritja e një institucioni për nxitjen eksporteve, i cili do të koordinojë aktivitetet e tij me rrjetin e agjencive zbatuese.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përqëndrimi i procedurave administrative.

- Nxitja e industrisë shqiptare për një qëndrim të integruar, duke filluar nga përmirësimi i aftësisë konkurruese ndërkombëtare deri në nxitjen e eksporteve.

Në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë, duhet të përdoren qëndrimet plotësuese dhe efektet e sinergjisë. Prandaj, theksi do të vihet mbi: **bashkëpunimin efektiv midis të gjithë aktorëve dhe koordinimin efikas të kontributit të donatorëve.** Duke patur parasysh avantazhet konkurruese të Shqipërisë - në veçanti fuqinë punëtore të arsimuar dhe me kosto të ulët, afërsinë me tregjet evropiane, rimëkëmbjen e tregjeve rajonale, burimet natyrore, politikat mjaft liberale tregtare si dhe potencialin e pashfrytëzuar në bujqësi, industrinë ushqimore dhe sektorin e minierave, në industrinë e lehtë dhe shërbimet - zëvendësimi i importeve nga eksportet, pritet që të luajë një rol përherë e më të rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Shqipërisë.

## LITERATURA

1. Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, viti 2002.
2. Studime të ndryshme në Ministrinë e Ekonomisë.
3. Të dhëna nga interneti.
4. Të dhëna nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.
5. Të dhëna nga shtypi i përditshëm.
6. Të dhëna nga INSTAT.